



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 671/12 Prot.

Tiranë, më 21.04.2022

V E N D I M

Nr. 38, Dt. 21.04. 2022

“PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR MODELIN E KONTRATËS

PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE SHKENCORE “

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 38, 95 të Ligjit Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, të Statutit të UST, Vendimin e KSSCBPSH nr 2 datë 28.02.2022 “Për vlerësimin përfundimtar të projekteve kërkimore shkencore të UST, për vitin akademik 2021-2022” të ndryshuar dhe në Vendimin e KKPBSH nr. 3 datë 20.04.2022, Senati akademik në mbledhjen e tij të datës 21.04.2022,

V E N D O S I :

1. Të miratojë modelin e kontratës për financimin e projekteve kërkimore shkencore, për vitin akademik 2021-2022.
2. Bashkëngjitur modeli i kontratës .
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Rektorati, Njesitë kryesore , Drejtoria juridike dhe zhvillimit të curikulave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr.Agron Kasa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

K O N T R A T Ë

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____/____/2022

E PËRGGJITHËSHME PËR PROJEKTE KËRKIMORE SHKENCORE *

“ _____ ”

Sot, më datë ____/10/2022, në Tiranë, ndërmjet:

Drejtuesit të Njesisë Kryesore _____; Drejtuesit të Njesisë Bazë, _____; Rektorit të UST-së, Prof.Dr. Agron Kasa; Administratori i UST-së, Znj. Mirlinda Galushit dhe Drejtuesit të Grupit Kërkimor të këtij projekti, _____:

lidhet kontrata me kushtet që vijnë:

1. Kjo kontratë mbështetet në Vendimin nr. 30, datë 28.03.2022 të Senatit të UST-së; Vendimin nr. 13, datë 05.04.2022 të Bordit të Administrimit si dhe Vendimin nr. 2, datë 28.02.2022 të Komisioni i kërkimit, projekteve dhe botimeve shkencore.
2. Dokumenti i Projektit për Kërkim shkencor me titull:

“ _____ ”

i paraqitur për financim në kuadrin e fondeve për kërkimin shkencor nga Buxheti i Shtetit për UST-në.

3. Financimi i projektit fillon më datë _____

Për vitin 2022 projekti do të financohet me _____ Lekë.

Për projekte që zgjasin më shumë se një vit, fondi për vitin pasardhës jepet pasi paraqitet raporti për realizimin e detyrave të vitit paraardhës dhe është lidhur kontrata për financim vjetor sipas modelit të dhënë në Aneksin II.

Aparaturat, pajisjet dhe baza tjetër materiale e nevojshme për kryerjen e studimit, sigurohet nga pala zbatuese, sipas rregullave financiare në fuqi.

4. Sipas nevojave dhe specifikave që ka projekti hartohen metodika, plane pune mujore, etj, për realizimin e tij.

* Palët, sipas rastit, mund të shtojnë, heqin ose modifikojnë pikat e parashikuara në këtë model kur e shohin të nevojshme.

5. Në rast se gjatë kryerjes së projektit lind nevoja për të bërë ndryshime në objektivat e tij, në afatet e kryerjes së fazave të ndryshme apo të projektit në tërësi, në personelin kryesor (punonjësit shkencorë), ose për lëvizjen e fondeve nga destinacioni i caktuar, ato mund të bëhen vetëm me dijeni e miratim të organit që financon projektin (UST-ja). Për këtë paraqitet kërkesë me shkrim.
5. Pala zbatuese, në fund të çdo faze të projektit, raporton në njësinë bazë ose njësinë kryesore (në rastet kur projekti përfshin më shumë se një njësi bazë ose kryesore) nga ku merr certifikimin dhe miratimin e realizimit të objektivave të fazës së perfunduar. Ky raport i hartuar nga njësi bazë dhe kryesore i kalon për miratim organit që ka miratuar financimin e projektit (Komisionit të vlerësimit të projekteve dhe botimeve shkencore). Komisioni pas marrjes së raportit mund të thërrasë për sqarime të mëtejshme Drejtuesin e Grupit Kërkimor. Për projektet që shtrihen në më shumë se një vit, rezultatet vjetore të projektit të kaluara sipas procedurës së përshkruar më lart i dërgohen njësisë bazë/njësisë kryesore dhe më pas Komisionit për tu miratuar së bashku me planin e detajuar të punës për fazat në vazhdim për vitin pasardhës, sipas modelit të dhënë në Aneks II. Në raste të veçanta, kur ecuria e projektit, për arsye të ndryshme nuk është normale, Drejtuesi i Grupit Kërkimor i kërkon me shkrim drejtuesit të njësisë bazë dhe kryesore për të raportuar më përpara se faza të permbyllet. Vendimet e marra nga njësi bazë dhe kryesore i dërgohen të argumentuara Komisionit i cili ka diskrecionin për të amenduar pjesë të projektit. Këto amendime kalojnë për miratim në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit të UST-së.

Njësitë që kanë dhënë miratim për projektin, si dhe Komisioni që ka miratuar financimin e projektit, mund të bëjnë vlerësime afatmesme dhe kontrole duke përcaktuar masat për ecurinë e mëtejshme të projektit.

6. Një kopje e studimit dhe e oponencave, menjëherë pas shqyrtimit dhe miratimit në njësinë bazë apo njësinë kryesore, vihet në dispozicion të organit që financon projektin, i cili organizon vlerësimin përfundimtar me grup ekspertësh, jo më vonë se dy muaj nga data e paraqitjes së materialit përfundimtar. Së bashku me studimin dorëzohet dhe situacioni përfundimtar i shpenzimeve të kryera sipas zërave.
7. Përdorimi i rezultateve dhe i informacionit të studimit nga zbatuesit do të jetë:
 - a) i lirë;
 - b) me autorizim të organit që financon projektin (në rastet kur informacioni dhe rezultatet përbëjnë vlera shtetërore dhe komerciale të veçanta).
8. Kur afati i kryerjes së studimit nuk respektohet për arsye të mosfinancimit në kohë, mban përgjegjësi organi që financon projektin, ndërsa për arsye të tjera mban përgjegjësi Drejtuesi i Grupit Kërkimor.

Kontrata është e vlefshme deri në fund të afatit të projektit, me përjashtim të rasteve kur, ajo shpallet e pavlefshme.

Kontrata u përpilua në gjashtë kopje me vlerë të barabartë. Secila palë (Njësia Kryesore, Njësia Bazë, Drejtuesi i Grupit Kërkimor, Adminstratori dhe Rektorati) mban një kopje.

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Drejtuesi i Njesisë Bazë

Drejtuesi i Njesisë Kryesore

REKTORI

Prof.Dr. Agron Kasa

ADMINISTRATORI

Mirlinda Galushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Aneks II

KONTRATË

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____/____/2022

PËR FINANCIM VJETOR

Viti 2022

Sot, më datë ____/____/2022, në Tiranë, ndërmjet:

Universiteti i Sporteve të Tiranës, institucion financues, përfaqësuar nga REKTORI

dhe Grupi Kërkimor Shkencor i Projektit përfaqësuar nga: _____

Drejtuesi i Grupit Kërkimor Shkencor _____,

në vijim të Kontratës së Përgjithshme ndërmjet palëve, lidhur më ____/____/2022 për financimin e projektit me titull:

“ _____ ”,

në kuadër të Strategjisë për Kërkimin Shkencor të Universitetit të Sporteve të Tiranës, lidhet kontrata me kushtet që vijojnë:

Për vitin 2022 projekti do të financohet me _____ Lekë.

Pikat e tjera të Kontratës së Përgjithshme nuk ndryshojnë.*

Drejtuesi i Grupit Kërkimor

Drejtuesi i Njesisë Bazë

Drejtuesi i Njesisë Kryesore

REKTORI

Prof.Dr. Agron Kasa

ADMINISTRATORI

Mirlinda Galushi

* Palët, kur ka arsye të arsyetuara dhe në mirëkuptim, mund të ndryshojnë pika të Kontratës së Përgjithshme, t'i heqin, t'i shtojnë ose t'i ndryshojnë ato, duke i specifikuar të gjitha këto ndryshime në Kontratën Vjetore të radhës.

SKEMA E RAPORTIT VJETOR

Për realizimin e detyrave dhe financimit për vitin në vazhdim Dhe Projektplanin e punës dhe financimit për vitin pasardhës

Raporti vjetor bëhet për çdo projekt më vete dhe i paraqitet organit finances në dyjavorin e parë të muajit Dhjetor të vitit në vazhdim. Ai përmban:

- I. Raportin për realizimin e detyrave të parashikuara në planin e punës dhe financimit (Aneks IV/1).
- II. Pasqyrën e realizimit të financimit sipas artikujve (Aneks IV/2).
- III. Projektplanin e detajuar të punës për vitin pasardhës (Aneks IV/3).
- IV. Projektplanin e financimit të projektit për vitin pasardhës (Aneks IV/4).
- V. Listën e plotë të pajisjeve që kërkohet të blihen dhe të shpenzimeve të tjera kapitale për vitin _____ (pasardhës) (Aneks IV/5).